



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenas /Glllogoc
Kuvendi i Komunës



Nr. 02-060/03-24450 dt. 23.05.2024

Në bazë të nenit 43 të Ligjit nr. 03/L-40 për vetëqeverisje Lokale, neni 36,41 dhe 42 pika 42.2 të Statutit të Komunës së Drenasit (Glllogocit), neni 3 pika 3.7 si dhe neni 12 pika 12.2 të Rregullores së punës të Kuvendit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Milaim Hajdari, më datë: **30.05.2024**, (E enjte) duke filluar në ora **10:00** në sallën e Kuvendit të Komunës.

THËRRET
MBLEDHJEN E RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS

Mbledhja do të ketë këtë:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal i mbajtur më dt. 29.04.2024.
2. Propozim vendim për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re.
3. Të ndryshme

Drenas, 23.05.2024



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Milaim Hajdari



Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-23831 dt. 20/05/ 2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit të Mbajtur më datë: **29.04.2024** e cila filloi në orën 10:00.

Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit Komunal-Milaim Hajdari
Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal, ku të pranishëm ishin 30 anëtarë: Labinot Halilaj (PDK), Bekim Lestrani (PDK), Arigon Sinani (PDK), Zeqir Hasi (PDK), Laurita Muhadri Bujupi (PDK), Hamit Kastrati (PDK), Blerina Gashi (PDK), Gani Krasniqi (PDK), Fatmir Baliu (PDK), Qendrim Mulaj (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Blerina Gashi (PDK), Valentina Leku (PDK), Manushaqe Mulaku (PDK), Mirlinda Dvorani (PDK) Sali Dvorani (DD), Mergim Pirraku (DD), Mehedin Salihu (DD), Hamit Haxhiu (DD), Jahir Hajdari (DD), Azemine Bujupi-Gjoka (DD), Marigona Bazaj (DD), Florentina Elezi-Veliu (VV), Filloreta Bujupi (VV), Drin Halilaj (VV), Egzona Terdevci (VV), Muhamet Kurtaj (VV), Arbër Halilaj (GREEN), Beqir Kiqina (AAK), Egzon Qorri (LDK). Sali Dvorani (DD). *Mungoi Florentina Elezi.*

Të pranishëm ishin edhe Kryetari i Komunës, Ramiz Lladrovci, Nënkryetari Arben Shala, Drejtor të Drejtorive komunale, përfaqësues të KFOR-it, përfaqësues të OSBE-s zyra e informimit, sekretari organizativ i Qendrës të LVV Nëntor Zeka.

Mbledhja filloi punimet me këtë rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Kuvendit Komunal të dt. 29.03.2024
2. Raporti Financiar Janar-Mars 2024.
3. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e nenit 85 të statutit të Komunës së Drenasit.
4. Propozim vendim për aprovimin Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr Hafir Shala" për Komunën e Glllogocit.
5. Propozim vendim për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për 25 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, për ndërtimin e nënstacionit Policor në zonën kadastrale Komoran të Komunës së Drenasit.
6. Propozim vendim Për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).
7. Të ndryshme.

Mbledhja e rregullt e Kuvendit të Komunës së Drenasit u mbajt me dt. 29.04.2024, ku për diskutim ishin 7 pika për rend dite. Mbledhja është kryesuar nga kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari.

Kryesuesi hapi punimet e mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal ku njoftoi me rendin e ditës e lartcekur. Diskutime për rendin e ditës.

Egzona Tërdevci: propozoj në emër të grupit të asamblistëve të Lëvizjes Vetëvendosje që pika gjashtë të hiqet nga rendi i ditës, arsyet, ndër të tjera pse duam ta heqim këtë pikë nga rendi i ditës është se as materiali nuk është i plotë, mundemi me pa materialin që na ka ardhë në e-mail, nuk janë shtatëdhjetë parcela shkruan numri shtatëdhjetë në renditje tabelare, po mungojnë shumë parcela, pesë parcela mungojnë zonës kadastrale në Drenas, mungon parcela e Baicës, këto i gjeni në listën paraprake që është e publikuar në faqe të komunës, i kemi pas edhe në janar, po nuk i kemi tash, duke i përmendë këto arsye, po edhe arsye që i kemi pas gjithëherë që prona publike të mos jepet në shfrytëzim, propozojmë që me u shty kjo pikë e rendit të ditës. Gjithashtu, propozoj që edhe pika katër e rendit ditës për statutin e Qendrës kryesore të Mjekësisë Familjare t'i hiqet nga rendi i ditës, arsye është se në statut nga neni gjashtë ka një kapërcim të nenit trembëdhjetë nuk mundemi me votu një statut i cili ka mangësi gjashtë në trembëdhjetë pra i ka mangësi shtatë nene propozoj që ta ktheni prapë në rishqyrtim, ta bini qysh duhet edhe hedhim në votim.

Marigona Bazaj: ne emër të grupit DD jemi kundër te kësaj pike dhe kërkojmë të hiqet nga rendi i ditës.

Labinot Halilaj: edhe unë e propozoj që kjo pike e rendit të ditës të hiqet, për vetëm një arsyetim, edhe pse njëqind herë i kanë dhënë arsyetimet e tjera, është gati një vit e gjysmë që i diskutojmë lidhur me listën e pronave dhe ende kësaj liste të pronave nuk janë prurë projekte se çka realisht mendohet të jepet shfrytëzim pronave publike dhe gjithmonë është justifikimi me atë që qëllimi i dhënies dhe me ligj është që të rritet vlera e pronës por na s'kemi qysh i arisim vlerën e pronës, kur realisht na nuk kemi projekte për këto pronat të propozuara për dhënie një shfrytëzim për 99 vite.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: rendin e ditës i keni marrë me kohë, të gjitha materialet i keni marrë me kohë. Sa i përket pikës gjashtë, e keni pas edhe para dy muajve, krejt materialet, asnjë gjë nuk e kemi heq, po flet diçka që s'e din, edhe ju ftoj me votu, materialet i kemi përcjell në rregull janë, nuk e kena sjellë krejt listën që e kena dergu më parë, i kemi detyrim me propozu kena dërgu listën fillestare e cila duhet mu votu dhe ka nevojë për votim, unë e kam obligim ligjor, ligji më detyron me e dergu listën për votim, lista është preliminare, nuk është lista përfundimtare e kur të vijë momenti nëse votohet, gjithmonë ne vendosim se cilat prona ose sipas interesit të kompanive që kanë interes me marrë pronat, ne i çojmë edhe ato prona. Ndërsa sa i përket pikës katër, pika katër është krejt në rregull nuk ka asnjë shqetësim.

Lumnije Krapit - Drejtoreshë e shëndetësisë: Sa i përket çështjes së ngritur nga ana e përfaqësueses së Grupit të Vetëvendosjes Domethënë, mund me ndodh ndonjë gabim teknik, e kam statusin me gjitha nenet që na ka marrë forma unike prej Ministrisë së Shëndetësisë edhe në debat, në diskutim publik ka qenë ok, mundet me qenë gabim teknik, aty mungesa e faqeve. Po s'muna me shty, se është në rregull.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari: fillojmë me votim, Egzona ka propozu, që me u tërheq pika e katërt dhe pika e gjashtë nga rendit i ditës. Duhet me shku në votim për të dyjat veç e veç.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari: hodhi në votim pikën e katërt të rendit të ditës me propozimin e Egzonës që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës: prezent ishin 30 anëtar: Për votuan 13 anëtar, kundër 16 anëtar, 1 abstenim. Pika e katërt e rendit të ditës nuk u miratua që të hiqet nga rendi i ditës, e njëjta mbetet në rend dite.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari: hodhi në votim pikën e gjashtë të rendit të ditës me propozimin e asamblesë që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës: për ishin 30 anëtar: Për votuan 15 anëtar, kundër 15 anëtar, abstenim nuk pati. Pika e gjashtë e rendit të ditës nuk u miratua që të hiqet nga rendi i ditës, e njëjta mbetet në rend dite.

Pas diskutimeve kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, “Për” votuan 16 anëtar, kundër 14 vota, abstenim nuk pati, u miratua rendi i ditës me pikat e lartcekura pa ndryshime.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt i Kuvendit Komunal Drenas të dt. 29.03.2024.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 30 anëtar, “Për” votuan 30 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës: 2. Raporti Financiar Janar-Mars 2024

Egzona Tërdevci: Atëherë është së pari po e nisim me një vërejtje teknike që ua kam përcjellë vazhdimisht, kur të na dërgoni raport të tilla me i numëru faqet, sepse është problem me ju referu se faqet s'kanë numër asnjëra prej tyre. Tek buxheti gjinor përmenden subvencionet për tetë gra. A mundeni me na sqaru për çka janë dhënë këto subvencione? Tek të hyrat vetanake qiraja për objekte komunale kodi pesëdhjetë katërqind e tetë është zero, Taksa nga të hyrat për shfrytëzim të pronës publike, edhe kjo është zero, nëse mund të kemi shpjegime për këtë kod si dhe a mundim me pas më shumë detaje për subvencionin, sepse me vendimin e shkurtit që të mbështeten anët lehona, është vendos që të mbështeten nga kategoria e shpenzimeve t'subvencioneve Drejtorisë për shërbime për shëndetësi, po këtu shuma është zero, nëse mund edhe për këtë pjesë me sqaru tek projektet kapitale është

shpenzu një shumë e vogël për ndërtimin e kapacitetit të ujësjellësit, nëse mundemi me pas më shumë detaje për këtë projekt edhe kodi 92159 për performancë nuk ka qenë kod buxhetor, as kur e kemi miratu buxhetin ne, e as buxhetin që është miratu nga Kuvendi i Kosovës, nëse mundem me pas edhe për këtë pjesë sqarime.

Albulena Saliuku, Drejtoreshë për buxhet dhe financa: ky është një raport financiar buxhetor që përfshin periudhën janar-mars 2024 i cili është përgatitur në bazë të dispozitave ligjore si dhe ofron informata që kanë të bëjnë me arketimin e të hyrave vetanake, shpenzimet si dhe të dhënat apo informata mbi investimet kapitale. Sa i përket performansës së të hyrave, gjatë këtij tremujori kemi vazhduar me grumbullimin e të hyrave buxhetore ku të hyrat direkte kanë shënuar një trend të ngjashëm krahasuar me periudhën e njëjtë të 2023 gjithsej, vlera e grumbulluar e të hyrave nga tremujori i parë i këtij viti është treqind e 314,990.73 € ose 90.98 % krahasuar me tre mujorin e parë të vitit paraprak ndërkaq sa i përket performansës së shpenzimeve për këtë periudhë shpenzimet buxhetore kanë arritur vlerën prej 4,055,521.04 € ose 18.35% të buxhetit të komunës për vitin 2024 dhe kjo vlerë e shpenzimeve kryesisht është bërë nga ekzekutimi i shpenzimeve për paga, shpenzimet komunale, subvencionet si dhe investimet e kapitale, ndërkaq, që kur jemi tek shpenzimet e komunaali, kjo kategori e shpenzimit ka shënuar rënie të cilat kanë arritur vlerën prej 40,957.61 € apo 11.75% krahasuar me buxhetin e 2024 dhe kjo shumë korrespondon më pak sesa periudha e njëjtë e vitit paraprak, domethënë kemi një rënie të shpenzimeve komunale për këtë tremujor në vlerë totale prej 7,400.42 €, ndërkaq tek shpenzimet kapitale janë realizuar me një normë të kënaqshme ato arritën vlerën prej 444,971.83 që është 5.93 % e buxhetit vjetor për vitin 2024 krahasuar me shpenzimet në këtë kategori gjatë periudhës së njëjtë të vitit 2023 kemi më shumë shpenzime për 206,112.04 €. Vlera prej 77,741.35 nga kodi i projektit të Grandit të përforamncës komunale (92159) është shpenzuar për projektin zgjerimi dhe ndërtimi i sheshit “Fehmi Lladrovci” Drenas. Sa i përket buxhetimit gjinor mund të themi se përqindja e femrave në listën e të punësuarve arrin në 53.68% dhe buxheti i pagave i shpenzuar për këtë kategori ka shkuar në këtë përqindje të shpenzimit. Në periudhën janar-mars komuna ka ndarë dhe subvencione për organizata jo qeveritare dhe individ në vlerë prej 53,091.06 €, gjithsej ishin 13 përfitues ku prej tyre 8 përfituese ishin femra. Sa i përket lehonave ne po flasim vetëm për periudhën janar-mars nuk besoj që janë përfshi gjatë kësaj periudhe.

Meqë nuk pati më diskutime kryesuesi i Kuvendit Komunal, **Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: 3. Propozim vendim për formimin e komisionit për plotësim ndryshimin e nenit 85 të statutit të Komunës së Drenasit.**

Kryesuesi njoftoi se nga Ekzekutivi propozuan Bekim Morina- anëtar nga ekzekutivi, Shqipe Hoxha- anëtare nga Shoqëria civile;

Bekim Lestrani propozoi: Fatmir Baliu

Azemine Bujupi propozoi: Arbër Ilalilaj

Drin Halilaj propozoi: Egzona Terdevci

Arigon Sinani propozoi: Hamit Kastrati

Marigona Bazaj propozoi: Azemine Bujupi Gjoka.

Më këtë propozim vendim formohet komisioni për plotësim ndryshimin e nenit 85 të Statutit të Komunës së Drenasit, të cilin Komision e përbejnë dy (2) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilin e propozon Kryetari i Komunës, tre (5) anëtar nga Kuvendi i Komunës:

1. Bekim Morina- anëtar nga ekzekutivi;
2. Shqipe Hoxha- anëtare nga Shoqëria civile;
3. Fatmir Baliu- anëtar nga kuvendi;
4. Arbër Halilaj- anëtar nga kuvendi;
5. Egzona Tërdevci- anëtar nga kuvendi;
6. Hamit Kastrati - anëtar nga kuvendi;
7. Azemine Bujupi Gjoka- anëtare nga kuvendi;

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- pas propozimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 29 anëtar, “Për” votuan 29 anëtar, kundër nuk pati, abstenim nuk pati, u miratua me propozimet e dhëna.

Meqë nuk pati më diskutime kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim vendim për aprovimin Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare “Dr Hafir Shala” për Komunën e Gillogocit.**

Egzona Tërdevci: e di që statuti i QKMF-së ka qenë konsultim publik e di që ka qenë edhe në ueb faqe, po ju keni përgjegjësi ndaj neve si asamblastë që të na dërgoni materiale të plota, e nuk është hera e parë që materialet i marrim të mangëta, nuk është në rregull që na me marrë një statut ë bahet kapërcim prej nenit gjashtë e nenit trembëdhjetë, se në këtë formë nuk mundem unë personalisht nuk votoj një dokument i cili nuk është i plotë si dhe kam një çështje tek neni katërmëdhjetë i këtij statuti tek paragrafi katërmëdhjetë, neni katër është i mangët, është diskutu edhe në këtë Kuvend, se në konkurset për zëvendës drejtor është shkelë Rregullorja e Brendshme e QKMF-së për sistemim, prandaj është e rrugës që të shtohet edhe një paragraf ku përcaktohet mënyra e saktë e zgjedhjes së zëvendës drejtorit.

Mehedin Salihu: me këtë ndërrim të statusit çka përfiton pacienti në këtë rast dhe çka punëtohet kur e dina që shtëpia e shëndetit e ka një statut dhe ka qenë mjaft i suksesshëm, kur ka mjaft çështje me prioritet që u dasht me u marrë drejtoria e shëndetësisë e nuk ka qenë me urgjenc statuti me u ndryshu.

Lumnije Krapit, drejtoreshë për shëndetësi: pika 14 neni 4 në ka procedurat për përzgjedhjen e zëvendës drejtorit, të udhëheqë Drejtoria Komunale për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. E kemi Rregulloren e brendshme që përcakton kriteret për për plotësimin e vendit të punës, 150 punëtorë kemi të drejtë me pas zëvendës drejtorin.

Egzona Tërdevci: Ato ceket që Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale është përgjegjëse, po bash në rregullore ceket që zëvendës drejtori duhet me kanë doktor, e konkurset e fundit që janë shpallë për zëvendës drejtor janë kanë kundërshtim me Rregulloren e Brendshme tash ju e vlerësoni qysh e bëni, po ndoshta është mirë me shtu që bëhen përkitazi me Rregulloren, po jo thjesht që drejtoria është përgjegjëse se prapë mujna me ardh në situatën e njëjtë, ku ju e bëni konkursin që bie ndesh me Rregulloren e Brendshme për Sistematizim.

Lumnije Krapë, drejtoreshë për shëndetësi: statusi i qendrës të mjekësisë familjare ku nga ky status dalin edhe rregulloret, si për Rregullorja për plotësimin e vendeve punës, si dhe si rregullore tjera të Këshillit Drejtues.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: kur ka veç një kandidat, ne me ligj e kemi detyru unë me i hapë rrugë edhe drejtimeve tjera. Nëse dikush nuk do me apliku prej doktorave, ne kena me gjet një situatë që e thotë ligji dhe na e kemi shpallë, pra edhe me drejtime tjera, me qëllim për me mujt me zhvillu procedura. Rregulloren e kemi me e përditësu, me plotësu sepse ligjet, kur u kon ky statut, nuk u ndërru nëse s'më gaboje por kan ndryshu ligjet kanë ndryshu rregulloret për shëndetësinë edhe ne jemi detyruar me harmonizu për ata dhe e kemi sjelle.

Mehedin Salihu: ashtu siç e dini edhe kryetari që sa vjet nuk ka shtëpia shëndetit zëvendës drejtor, pasi që vetëm po ju referoni rregulloreve, edhe shumë jeni të ngadalshëm veprimet e juaja drejtoreshë, nëse një punëtor shëndetësor, në këtë rastin konkret, zv.drejtori i zgjedhur është perfekt, menjëherë aty për katër vjet u dasht me marr një doktor te ri, por nuk po i plotësoni vendet e lira të punës.

Lumnije Krapë, drejtoreshë për shëndetësi: e kemi qitë konkursin për plotësimin e vendeve të punës, konkursin e fundit, e kemi hapë konkursin për plotësimin e vendit të punës në Gllanasellë, mirëpo qysh tha edhe kryetari Rregullorja nuk e lejon që në konkursin, domethënë fillimisht duhet me qenë tre kandidatë, nëse nuk e nuk janë tre kandidatë që i plotësojnë kriteret, atëherë duhet me u ba plotësimi për afatin e dytë. Në momentin në momentin që me udhëzim administrativ, domethënë me statusin e QKMF-së mbi njëqind e pesëdhjetë punëtorë kemi të drejtë me pa zëvendës drejtor, ne e kemi vetëm e kemi ë zbatu statusin në edhe udhëzimet administrative.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 28 anëtar, "Për" votuan 14 anëtar, 13 kundër, 1 abstenim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për 25 vite të pronës komunale të Komunës së Drenasit Ministrisë së Punëve të Brendshme – Policisë së Kosovës, për ndërtimin e nënstacionit Policor në zonën kadastrale Komoran të Komunës së Drenasit.**

Beqir Kiqina: sa i përket pikës së pestë të rendit të ditës Propozim-vendim për dhënie në shfrytëzim afatgjatë, termi afatgjatë për njëzet e pesë vite, mua po më duket që nuk përputhet, është afatshkurtër në dyzet vjet se janë pronat afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë, kërkoj një sqarim.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: çdo propozim-vendim prej pesëmbëdhjetë vjet deri në nëntëdhjetë e nëntë vjet është afatgjatë, ndërsa kur është nën 15 vjet është afatshkurtër.

Egzona Tërdevci: siç e dini, kanë qenë qëndrime publike, në seancën e kaluar kemi kërku që të shtyhet kjo pikë, derisa t'i marrim sqarimet, ne i kemi marrë sqarimet përkatëse nga Ministria e Punëve të Brendshme. Ne e mbështesim kërkesën e Policisë për t'ia dhënë në shfrytëzim pronën që e kanë kërkuar, as herën e kaluar s'kemi qenë kundër policisë, thjesht kemi pas dilema e cila është dashtë me sqarë dhe institucioni më i besueshëm ë në Kosovë, pra Policia e Kosovës patjetër që e ka edhe mbështetjen tonë.

Marigona Bazaj: duke pasur parasysh përpjekjet e ngutshme të kryetarit për të bërë transaksione me pronat komunale dhe në veçanti duke parë propozim-vendimin e kryetarit të komunës për pronën që ishte në shfrytëzim dhe për objekt biznesor në Komoran të Drenasit Dua që të ju njoftoj se propozim-vendimi i kryetarit të komunës për bartjen e kësaj prone tek institucioni më i besuar i Republikës së Kosovës është kontestimor dhe problematik që të mos dëmtoni bizneset dhe të mos implikohen komuna pa nevojë, me kaq urgjencë, Policia e Kosovës duhet të marrë përgjigje pozitive, por jo për këtë pronë, sepse kjo çështje nuk ka marrë ende epilogun gjyqësor. Jemi njoftuar se prona në kontest që kishte në shfrytëzim pala në mënyrë legale, komuna ua ka ofruar për të përdorur si stacion policor, Policisë së Republikës së Kosovës. Andaj, ju sjellim në dijeni se të keni angazhim konstruktiv dhe të mos nguteni për marrjen e vendimeve eventuale sepse kjo çështje është në kontest gjyqësor, Kemi dëshmi padinë e Gjykatës Themelore në Drenas dhe ende nuk ka marrë epilog kjo problematikë. Pra, ju sjell një dijeni se për këtë pronë ka problematikë kontestimore dhe ka proces gjyqësor të papërfunduar. Madje, ju njoftoj se kontrata mbi shfrytëzimin e kësaj prone bashkëngjitur kontrata për shfrytëzim të pronës numër 465-1036 mbron investimin e palës që kishte në shfrytëzim këtë pronë, sipas kontratës është mundësia e vazhdimit dhe në rast mosvazhdimi, prona duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme. Kjo nënkupton se duhet rrënuar, prandaj ju lutem të mos nguteni në veprime pa ndriçuar rastin. Kjo problematikë ka edhe masë të përkohshme për procedurë administrative nga Agjensioni i Kadastrit të Kosovës edhe për këto dëshmi vendimi AKK-së 03/1822-18 të cilin komuna nuk e ka zbatuar. Ju lutem, konsultohuni me zyrën tuaj ligjore dhe vlerësoni se a vlen ligji i ri apo i vjetër. Kontrata i njeh mundësinë e vazhdimit sipas nenit 11 nëse nuk ndodh vazhdimi, pronat duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme. Ne jemi tej mase të çuditur se prej nga buron kjo zemërgjerësia e dikujt të bëjnë nder me ndjerës të biznesit privat dhe prej nga kjo nguti duke shkelë procedurat administrative dhe procedurat gjyqësore. A nuk ju duket e ngutshme dhe tendencioze kjo çështje, të nderuar përfaqësuesit e qytetarëve? Ne besoj se këtu jemi për të mbrojtur lirinë dhe të drejtat e njeriut. Me këtë nguti kam bindjen se po shkelim mbi lirinë dhe të drejtat elementare të qytetarëve tanë. Unë dyshoj se policia paska qenë në dijeni dhe paska prona të gatshme dhe objekt me leje ndërtimore për stacionin policor. Ne gëzojmë shumë respekt për këtë institucion kredibil ndër më të besueshmit në Republikën e Kosovës dhe besoj se nuk do të bie në lajthitje dhe pa maturi dhe të dëmtohet djersa dhe investimi nga një biznes privat në Komoran. Të kemi në konsideratë ndjesinë, ne ju besojmë c ju bëj me dije se policia ka pronë të saj rreth gjashtëdhjetë hektarë pronë të vetme në Komoran. Pse iu dashka prona e kontestuar me sipërfaqe më të vogël dhe në pjesën e pronave të planifikuara e destinuara për zhvillim biznesor? Leja ndërtimore është për biznes dhe jo për institucione shtetërore. Ne e vlerësojmë se biznesi t'i është bërë një mashtrim me kontratën dhe për këtë arsye kërkuam që të hiqet menjëherë nga rendi i ditës.

Arbër Halilaj: në seancën e kalume kam qenë kundër këtij propozimi, jo kundër Policisë së Kosovës qysh mundet me interpretu dikush, mirëpo gjithmonë jam kundër që kur një qytetar ose institucion ka kontest gjyqësor me komunën, atëherë të mos mbivendoset Kuvendi Komunal para organeve të drejtësisë, e gjithashtu edhe me hartën zonale që është miratu në këtë Asamble, ka pika që janë mospërputhje me kërkesën, do të thotë ta zëmë pika nëntë pikë shtatë: qendra dhe administrative, ku hyn edhe siguria publike, Thotë që në përputhje me kushtet zhvillimore të përgjithshme dhe duke iu referuar udhëzimit administrativ, parcelat ku do të vendosen institucionet administrative do të planifikohen në pjesën qendrore të vendbanimeve, mandej edhe të shfrytëzimi i tokës në këtë kufi kadastral, domethënë në Glllogoc, Çikatovë e Re dhe Komoran, pika 5.8 ceket për çfarë do të shfrytëzohet toka përgjatë rrugëve nacionale dhe regjionale, askund nuk e shoh që ndërmjet bizneseve parashihet që të instalohen institucione publike. Gjithashtu, çështje tjera që i cekti kolegja, që në njëfarë forme duhet të sqarohen dhe ne si Asamble të votojmë të mirëinformuar edhe do të thotë votojmë në favor të kërkesës, mirëpo pasi të sqarojnë këto çështje që janë në procedurë gjyqësore.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: prona është e komunës, mbaj përgjegjësi ligjore, pronën e ka kërku një institucion më i rëndësishëm i sigurisë për Kosovën në qendër të Kosovës, pas verifikimit të çdo dokumenti zyrtar. Dhe si ua merr mendja që vendoset policia në një objekt si ka konteste gjyqësore.

Arbër Halilaj: kërkoj një sqarim se a ka një vendim që ka përfundu kjo procedurë gjyqësore, përndryshe mua nuk kam thërret kërku, nuk diskutoj këtu me direktiva të kërkujt Dëshmoni që ka përfundu procedura gjyqësore edhe çka nënkupton neni 11 i kontratës që e ka nënshkru pala me Komunën. Përndryshe, kushdo që është në pyetje, kur është investim i biznesit, unë dua sqarime dhe arsye time pse dhe çka po votojmë. Neni 11 thotë: Pronat kthehet në gjendjen e mëparshme do të thotë, objekti që është aty do të rrenohet nëse hipotetikiht Gjykata vendos kundër palës.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: Prona japet në shfrytëzim me qëllim të ngritjes, vlerës të pronës, pra prona e ka vlerën, sepse e ka edhe një objekt, prona është në emër të komunës, prej momentit që i ka dalë kontrata dhjetëvjeçare.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- pas diskutimeve që u dhanë kryesuesi hodhi në votim ketë pikë të rendit të ditës: prezent gjatë votimit ishin 18 anëtar, "Për" votuan 14 anëtar, 3 kundër, 1 abstenim, ndërsa asamblist të tjerë lëshuan sallën nuk morën pjesë në votim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal, Milaim Hajdari- hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: 6. Propozim vendim Për miratimin paraprak të Vendimit për dhënien e pronave të paluajtshme të Komunës së Glllogocit në shfrytëzim afatgjatë personave fizik/juridik (për 99 vite).

Egzona Tërdevci: Si grup i asamblesëve të Lëvizjes Vetëvendosje parimisht jemi kundër dhënies së pronave në shfrytëzim për nëntëdhjetë e nëntë vite, kur ato nuk ipen për institucione publike E arsyet për ta kundërshtuar edhe më shumë këtë vendim, rriten me faktin se nuk ka një analizë të mirëfilltë në atë se si ndikon në aspektin ekonomik dhënia në shfrytëzim i këtyre pronave dhe cili është përfitimi që e ka komuna jonë nga ky veprim fakti që sot para nesh kemi një propozim për t'i dhënë në shfrytëzim shtatëdhjetë prona për nëntë-

nëntë vite, tregon se sa shumë e vlerëson zotëri Lladrovci pronën publike e si po provon ta keqpërdoret në kurriz të jetës publike të qytetarëve. Jemi dëshmitarë të asaj se dhënia në shfrytëzim e pronave për nëntëdhjetë e nëntë vite për persona fizikë e juridikë as nuk i ka sjellë përfitime të mëdha komunës, siç është pretenduar shpesh e as nuk kanë përfituar qytetarët nga to, të vetmit përfitues i këtyre investimeve janë ato biznese që duke mos duke mos i realizu investimet sipas kriterëve, duke iu shmangur premtimeve për punësimin rekordit të punëtorëve për ne në Vetëvendosje shqetësues është secila pronë nga lista e shtatëdhjetë pronave që do të jepet në shfrytëzim për nëntëdhjetë e nëntë vite gjithëherë duke mos pas një analizë që mirëfilli e paraqet përfitimin që do të ketë komuna nga dhënia në shfrytëzim e këtyre pronave, por në mesin e këtyre pronave ka prona që do të duhej të mbeteshin publike gjithnjë e ka prona që tashmë po shfrytëzohen për ky vendim, po merret sa për thy e fa që e thjeshtë për le t'i legjitimu ato. Po filloj me parcelën 1032-2, apo objektin e vjetër të Komunës së Drenasit, ky objekt me ngulm ishte provuar të ipen nga ajo në shfrytëzim për nëntëdhjetë e nëntë vite, në fund të vitit dy mijë e njëzet e dy për të siguruar vota, që ta kaloni këtë pronë në pronësi të miqve tuaj që ju kanë ndihmuar gjatë fushatës. Zotëri Lladrovci, duke e kamuflu me arsyetimin e zhvillimit të qytetit, nuk keni lënë derë pa trokite e pazarë, pa provu për t'i siguru atëherë këto vota, me qëllimin e vetëm që t'i ktheni nderët që ata bënë, por ua kam thënë edhe më herët, po ua them prapë: favorët e fushatave i ktheni më parë juaja, jo më paratë e qytetarëve, si qytetare e këtij vendi nuk mundem me kuptu se cili është interesi publik e ekonomik i komunës që objekti i komunës së vjetër të shfrytëzohet për ndërtim të lartë ky objekt ku gjendet salla e vetme e kulturës në qytetin tonë duhet të mbetet objekt publik, veç sallës së kulturës me një renovim, e kam përmendë edhe më herët, do të krijoheshin hapësira që do të mund të shfrytëzoheshin në të mirë të qytetit. Nga fundi i vitit 2022, ku më ngulën kërkohej që kjo hapësirë t'i ipet për disa biznese të Drenasit e për t'ua shtu fitimin e tyre pasi interes publik assesi nuk ishte në këtë mes vetë komuna disa herë ka bërë organizime të ndryshme po në sallën e Kulturës, po e ripërsërisim. Nga viti 2022 në këtë objekt bënë një punë të jashtëzakonshme edhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave dhe është mëkat që një organizatë e tillë të mbetet pa objekt për ta ushtruar veprimtarinë e tyre. Shpesh në këtë Kuvend është përmendë që ato gra do të vendosen në një objekt dinjitoz për to, po sikur të kishe vullnet kjo çështje do të kish ndodhë moti, e jo pasi që të rrënohet ai objekt nëse veç ipet. Parcela 13-0 në Gillobar tashmë është duke u rregullu si parking për pishat, por çuditërisht e krejt rastësisht është aq afër një parcele ku po ndërtohet një restorant sa pa problem mund ta përdorin edhe atë. Çka është e pakuptueshme për ne është se si mund të propozohet të jipet për shfrytëzim një pronë publike që tashmë i takon qytetarëve dhe është tu ndërtu një parking që ka me shfrytëzu për pisha. Një parcelë tjetër për të cilën kemi diskutuar shumë në këtë Kuvend është 743-30, parcelë kjo për shpronësimin e të cilave e kemi kundërshtuar edhe në prill të vitit 2022, tani kur e shohim se kjo parcelë planifikohet për ndërtim të lartë, e kuptojmë edhe më mirë mospërkrahjen tuaj ndaj qytetarëve kur ata kishin marrë një shpronësim të padrejtë për këto prona, të freskëta i kemi kujtimet se si kishit provu të manipuloni me votimin për këtë shpronësim, ku votimin me vetëm pesëmbëdhjetë asamblistë në sallë e kishit konsideru suksesshëm, e vetëm pas vërejtjeve tona që do ta dërgojmë rastin në MAPI, ishit detyruar ta përsëritni votimin, duke sjellë një asambleiste tuaj nga pushimi i lehonisë me detyrime për të votuar. Në këtë listë është edhe parcela 768-2, ku është çerdhja e vetme publike në Drenas, edhe kjo është për ndërtim të lartë. Çka me fol tjetër për këtë absurditet, ku toka ku gjendet e vetmja çerdhe publike don me u dha për ndërtim të lartë, pra për banesa. Për parcelën 126-2 ka një padi ndaj

komunës për këtë çështje. Kjo pronë ka qenë në shfrytëzim më herët nga një përdorues i cili është shkëputur kontrata për t'u rezervuar më pas kjo pjesë nga kompania që ka në shfrytëzim pronën afër kësaj pronë madje sipas informacioneve ka edhe ka dhe një vendim gjyqësor lidhur me këtë çështje, nga krejt kjo mund të konkludojmë se tashme se është e përcaktuar se dhe kujt do t'i jepet kjo pronë, janë propozuar më shumë se 20 prona bujqësore për tu dhënë në shfrytëzim për 99 vite, nuk e kuptoj se cila kulturë bujqësore ka nevojë për 99 vite që më u prodhu. Parcela 726-17 ku ndodhet qendra e re tregtare sa kemi informacion këto prona janë blerë nga pronaret dhe janë bërë investime të shumta kurse tani edhe kjo parcele do të jepet në shfrytëzim për ndërtim të lartë për 99 vite. Duke parë të gjitha këto parregullsi dhe tendenca për të tjetërsua pronën publike ne si LVV asesi nuk e mbështesim një propozim të tillë me qëllimin e vetëm të jemi në mbrojtje të mirës së përgjithshme dhe pas diskutimeve do ta lëshojmë sallën.

Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci: krejt çka ke fol janë të pavërteta, asnjë pronë deri me tani që e kam dhënë unë dhe që e keni votu ju në kuvend me shumicë votave nuk është keqpërdor dhe as nuk është duke u keqpërdor, objekti i komunës të vjetër ka qenë një pronë që i ka kalu të gjitha procedurat dhe që nuk u votua në kuvend ose të njëjtën gjë që po e bëni tani që po e lëshoni sallën dhe po e pengoni zhvillimin e komunës, keni provu me mashtru Mistrinë e Kulturës me e shpall trashëgimi kulturore sallën e kulturës mirëpo nuk të ka funksionua, për Qendrën për promovimin e grave gjithçka përtej mundësive të mija jemi në shërbim të atyre grave prandaj e kemi ndërtuar objektin për ato që do t'ia japim në shfrytëzim mirëpo unë nuk kam drejt me ble mobile në emër të komunës për objektin e tyre dhe jemi në procedura dhe për me i ndihmu me ble mobile, ku jam participues në vlerë prej 1.000 € për ato gra që po e bëjnë punën e tyre me sakrificë. Për pronën tek çerdhja as nuk e kemi në proces as nuk e kemi drejt me qit në proces për aq kohë sa çerdhja është aktive, çerdhja nuk po ndërtohet për shkak të bllokadave nga bashkimi evropian i fondeve për ndërtim e zhvillim është mirë qeverisë me ia adresu këto çështje, as qendrën tregtare askush nuk e ka prek e as nuk e ka në plan, tek stacioni i autobusëve jemi duke e bërë një parking jo për interesa të uzurpimit por me ia dhënë në shfrytëzim qytetareve tanë parking pa pagesë. Pse duhet me u dhënë pronat në shfrytëzim këna kërkesë nga kompania gjermane e rritjes dhe prodhimit të rosave e cila e ka një funksionim të vetin në Skenderaj për një pronë në mes të Gllanaselles dhe Likoshanit, kemi kërkesë nga një kompani britaneze për një pronë tek "Kroni i mbretit" për fabrikën për prodhimin e dritave inteligjente dhe kamerave inteligjente, kemi kërkesa tjera për prodhimin e energjisë solare, kërkesë tjetër kemi edhe nga kompania tjetër që e ka pronë të veten feronikelin është i interesuar që me vendos panela diellor është i interesuar me marrë edhe prona tonat të pa shfrytëzuara, kompania Al-trade ka kërkuar një pronë në Arllat me negocu për më mujt me marr me zhvillu për me i punësua punëtor dhe komuna mundet me perfitu prej asaj prone dhe kjo është në interes të zhvillimit të komunës tonë dhe në interes të përgjithshëm të qytetareve tanë, e ceke edhe për tek pishat në Gllobar e ceke për parking dhe e paska dikush një objekt që po e ndërtohet afër parkingut pronën po ia marrim uzurpatorit, prona tek komuna në hartë zonale është ndërtim i lartë në mundemi me zhvillu procedura, ju po i bllokoni investimet dhe zhvillimin në komunën tonë, ne e kemi për obligim me i ndjek procedurat ligjore ne e kemi për obligim me e sjellë në kuvend dhe e kemi sjellë dhe është çështje e kuvendit me votu.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal kërkoj rreth një orë pauzë për arsye se nuk pati kuorum më për shkak se e lëshuan sallën disa nga asambleistë dhe vetëm 15 prej tyre qëndruan në sallë.

Pas pauze u rikthyen prap në sallë, por prap nuk pati kuorum dhe në mungesë të kuorumit mbledhja u ndërpre deri në një njoftim të radhës ndërsa kryesuesi kërkoj nga Sekretaria e Kuvendit që vendimet që janë miratuar t'i përcjellin për MAPL

Kryesuesi me një shkresë njoftoi se vazhdimi i Mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të Drenasit, të mbajtur më 29.04.2024, e cila u ndërpre për mungesë kuorumi, mbledhja do të vazhdoj për një ditë tjetër, ku për datën dhe orën e vazhimit të mbledhjes së rregullt, me pikat e rendit të ditës që kanë mbetur pa u shqyrtuar, do t'ju njoftojmë me kohë.

Me gjerësisht, mbledhjen e rregullt të Kuvendit të Komunës së Drenasit të datës 29.04.2024 mund të ndiqni në ueb faqen zyrtare të komunës, rrjetin social të Facebook-ut dhe në kanalin YouTube. <https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=7VCPtNmDAJk>

Procesmbajtëse:



Liridona Fejza-Ajazi



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Milaim Hajdari



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Drenas(Gllogoc)
Zyra e Kryetarit



Nr.01- 400/01- 22989 , dt. 14/05/.2024

Në vështrim të nenit 58, paragrafi 1, nën paragrafi h të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kryetari i Komunës së Drenasit, propozon: që në bazë të nenit 12 dhe 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, si dhe kërkesës për ndarje nr.06-070/01-22711 të dt.13.05.2024, që Kuvendi i Komunës së Drenasit, në mbledhjen e mbajtur me datë _____ 2024, të miratoj këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për ndarjen e parcelës kadastrale 326-4 Çikatovë e Re

Neni 1

Me këtë propozim vendim, kërkohet miratimi i ndarjes së parcelës kadastrale në Çikatovë e Re, me qëllim të realizimit të projektit për ndërtimin e ndërtimit të objektit për persona me aftësi të kufizuar (prapambetje mendore).

Neni 2

Parcela që kërkohet të ndahet, është si më poshtë:

- Parcela kadastrale Nr.326-4 me sip.42991 m² zona kadastra le Shtrubullojë, propozohet që të bëhet ndarja e kësaj parcele kadastrale, ku prej sipërfaqes së përgjithshme të ndahet sipërfaqja S=2500 m².

Neni 3

Qëllimi i ndarjes së parcelës kadastrale 326-4 në zk.Çikatovë e Re, bëhet për t'i hapur rrugë ndërtimit të objektit për persona me aftësi të kufizuar (prapambetje mendore).

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

Neni 5

Ky propozim vendim hyn në fuqi pas aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga ana e MAPL-së.



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci
Ramiz Lladrovci

ARSYETIM

Në bazë të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L – 048 ,Komuna e Drenasit obligohet të miratoj këtë propozim- vendim, me qëllim të ndërtimit të shtëpisë se komunitetit për persona me aftësi të kufizuar (SHKPAK), në Zonën Kadastrale Çikatovë e Re, kërkohet që të bëhet ndarja e parcelës kadastrale 326-4 si më poshtë:

Për të realizuar ndërtimit të objektit për persona me aftësi të kufizuar (prapambetje mendore), në zonën kadastrale Çiaktovë e Re, nevojitet një sipërfaqe prej 2500 m², prandaj edhe do të bëhet ndarja e parcelës 326-4, ku nga sipërfaqe e përgjithshme e kësaj parcela do të ndahet sipërfaqja prej 2500 m².

Bashkangjitur i gjeni:

- Certifikatën mbi të drejtat e pronësisë
- Kopjen e planit dhe
- Skicën e propozuar për ndarje.
- Buxhetin e ndara për këtë investim



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70315052-00326-4

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	07-942-22692
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	14.05.2024 - 09:59
Komuna / Opština / Municipality:	GLLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Çikalovë E Re / Novo Çikalovo / Çikalovë E Re
Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	GLLOGOC / GLOGOVAC / GLOGOC

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70315052-00326-4	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Imovina / Socially owned Land	Rural	42991	Sipas kërkes se iverit me nr 942-942-10548 me dt. 20.07.2017 gjeddeti Safet Hoxha14-2004	12.02.2018	31.07.2023

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
FSHAT-LEDINË			12.02.2018	31.07.2023



A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area (m ²) (m ²)
1	Tokë Ndërtimore/Gradjevinsko zemljište/Construction land	Trrall/Zemlische/Land		42991

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licni broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Druzavina / Single possessor	Komuna e Glllogocit	600316708	GLLOGOC / GLOGOVAC / GLLOGOC /		FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI	1/1	14-2004	12.02.2018





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE


AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : GLLOGOC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Çikatovë E Re

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-70315052-00326-4	Parcelë / Parcela / Parcel	42991



Shkalla/Razmera/Scale: 1:2772

Punoi/Obradio/Created: Fadil Tahiri

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:



Data/ Data/Date: 14.05.2024

Koha/ Vreme/ Time: 10:10:29



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC



Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë
Sektori për Gjeodezi
Zona Kadastrale Qikatovë e Re
dt.14.05.2024

Skicë e propozuar për ndarje të parcelës



P: 1500

Një pjesë të parcelës nr.00326-4 kemi propozuar për ndarjen e saj e cila parcelë është në pronësi Komuna Gllogoc, shfrytëzimi aktual është tokë ndertimore me sipërfaqe $S=4.29.91\text{ha}$
Sipërfaqja e propozuar për ndarjen e parcelës është $S=0.25.00\text{ha}$
Në skicë kemi paraqitur parcelen me ngjyrë të kuqe.

Shefi i Sektorit të Gjeodezisë



Drejtori për DGJKP

Tabela 10: Hapjen e shtëpive të reja për vitin 2024-2026

Financimi për shtëpitë e komunitetit për persona të moshuar (SHKPM)

Nr.	Komunat	Staf	Paga dhe Shtesa	Mallra dhe Shërbime	Shpenzime Komunale	Shpenzime Kapitale	Gjithsej 2024	Gjithsej 2025	Gjithsej 2026
7	Klinë	13	50,000	45,000	5,000	50,000	150,000	200,000	200,000
8	Gjakovë	13	50,000	45,000	5,000	50,000	150,000	200,000	200,000
9	Ferizaj	13	50,000	45,000	5,000	50,000	150,000	200,000	200,000
10	Podujevë	13	50,000	45,000	5,000	50,000	150,000	200,000	200,000
11	Gjilan					230,000	230,000	200,000	200,000
12	Pejë					230,000	230,000	200,000	200,000
13	Mitrovicë					230,000	230,000	200,000	200,000
14	Kaqanik					230,000	230,000	200,000	200,000
15	Vushtrri					230,000	230,000	200,000	200,000
16	Fushë Kosovë								250,000
17	Leposaviç								250,000
19	Rahovec							200,000	200,000
Gjithsej SHKPM		52	200,000	180,000	20,000	1,350,000	1,750,000	2,000,000	2,500,000

Financimi për shtëpitë e komunitetit për personat me aftësi të kufizuar (SHKPAK)

9	Malishevë	11	50,000	50,000	5,000	50,000	155,000	200,000	200,000
10	Viti	11	50,000	50,000	5,000	50,000	155,000	200,000	200,000
11	Prishtinë					230,000	230,000	200,000	200,000
12	Glogovc					230,000	230,000	200,000	200,000
13	Gjakovë					230,000	230,000	200,000	200,000
14	Rahovec					230,000	230,000	200,000	200,000
15	Podujeve					230,000	230,000	200,000	200,000
16	Dragash								250,000
17	Mitrovice Veriore								250,000
18	Obiliq							250,000	200,000
19	Pejë							250,000	200,000
Gjithsej SHKPAK		22	100,000	100,000	10,000	1,250,000	1,460,000	1,900,000	2,300,000

Financimi i shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve (SHEMF)

1	Prishtinë	10	52,500	45,000	5,000	50,000	152,500	215,000	215,000
2	Gjilan	10	52,500	45,000	5,000	50,000	152,500	215,000	215,000
3	Peje	10	52,500	45,000	5,000	50,000	152,500	215,000	215,000
4	Mitrovicë	10	52,500	45,000	5,000	50,000	152,500	215,000	215,000
5	Prizren					230,000	230,000	215,000	215,000
6	Ferizaj					230,000	230,000	215,000	215,000
7	Gjakove					230,000	230,000	210,000	210,000
Gjithsej SHEMF		40	210,000	180,000	20,000	890,000	1,300,000	1,500,000	1,500,000
Gjithsej SHEMF, SHKPAK, SHKPM		114	510,000	460,000	50,000	3,490,000	4,510,000	5,400,000	6,300,000